



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2022/6 prot

Datë 21.08.2024

V E N D I M
Nr. 1100/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.08.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK, me NIPT (J61901094G) dhe NIPT (L61411012R), me adresë: Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89. Shk.A, Kati 10, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorit ekonomik ankimues janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tij duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.06.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-07795-06-03-2024, me object: “*Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 18.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK	73,644,891 lekë,	skualifikuar
2. “Dion - AL” SHPK	78,004,530 lekë,	kualifikuar
3. “INA” SHPK	85,172,695 lekë,	kualifikuar
4. “RSM Company” SHPK	88,243,200 lekë,	skualifikuar
5. “2N” SHPK	92,150,530 lekë,	kualifikuar
6. “Valona Konstruksion” SHPK	99,712,120 lekë,	kualifikuar
7. “Junik” SHPK	99,999,999 lekë,	kualifikuar
8. “Rej” SHPK	101,060,925 lekë,	kualifikuar
9. “Zeqillari” SHPK	106,685,090 lekë,	kualifikuar
10. “Ndregjoni” SHPK	107,808,580 lekë,	skualifikuar

II.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

-Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk plotëson të gjitha kërkesat e vecanat për kualifikim sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, Shtojca e 8 e DST, mbi disponimin e një punonjësi të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Për plotësimin e kësaj kërkesë vetëm antari i BOE operatori ekonomik “R & T” sh.p.k. ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon këtë punonjës, me iniciale E. N., si dhe ka paraqitur Çertifikatën e Kualifikimit me kod kursi HS003, lëshuar nga shoqëria Re Born. sh.p.k. dhe kohëzgjatje 80 orë.

Referuar Çertifikatës së Kualifikimit paraqitur ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, kohëzgjatja e kursit nuk plotëson kushtin në dokumentat e tenderit sipas shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, që çertifikimi përkatës të jetë në përputhje me VKM-në nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", ku në nenin 10 parashikohet se “Kursi I formimit për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të jetë me kohëzgjatje jo më pak 120 orë:

Neni 10 VKM-në nr.312, date 05.05.2010

3. Përmbajtja dhe kohëzgjatja e kurseve për të cilat flitet në pikën 2 duhet të respektojnë të paktën kërkesat e pikës së mëposhtme 8.

8. Kurs formimi për sigurinë e punës në sektorin e ndërtimit:

a) Kohëzgjatja 120 orë.

b) Përmbajtja legjislativore në fuqi për sa i përket fushës së sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës; sëmundje profesionale; statistikat mbi shkeljet e rregullave në kantiere; analizimi i rreziqeve; rregullat teknike dhe kriteret për organizimin e kantierëve dhe kryerjen e punëve në kushte sigurie (përdorimi i makinave, PMP-ve, skelave dhe ndërtimeve të përkohshme etj.); metodat për përpunimin e planeve të sigurisë dhe të koordinimit.”

II.3.1. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokoli 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ku nga shqyrtimi paraprak i saj, u konstatua se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kundërshton skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2022/2 prot., datë 23.07.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK.

II.3.3. Njëpërmjet shkresës me nr. 438/8 prot., datë 29.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 2022/3 prot., datë 31.07.2024 me objekt “Dërgim vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet se ankesa është refuzuar.

II.4. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 05.08.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

II.5. Në datën 07.08.2024, njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokoli 2229/2024, datë 07.08.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ku nga shqyrtimi paraprak i saj, u konstatua se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kundërshton skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim

Nr.2229/2 prot., datë 08.08.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK.

II.5.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 438/13 prot., datë 15.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2229/3 prot., datë 16.08.2024 me objekt “*Dërgim vendimi*” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është pranuar plotësisht..

II.5.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK dhe me vendimin nr. 438/12 prot., datë 15.08.2024, ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

[...] Vendosi:

1. *Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “R&T” SHPK.*

II.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të “Ligjit për Prokurimin Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankimin elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokollin 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht, KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 04.06.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-07795-06-03-2024, me object: “*Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

III.1.2. Në datën 18.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e

vlerësimet të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE "R&T" SHPK & "I.B.S" SHPK	73,644,891 lekë,	skualifikuar
2. "Dion - AL" SHPK	78,004,530 lekë,	kualifikuar
3. "INA" SHPK	85,172,695 lekë,	kualifikuar
4. "RSM Company" SHPK	88,243,200 lekë,	skualifikuar
5. "2N" SHPK	92,150,530 lekë,	kualifikuar
6. "Valona Konstruksion" SHPK	99,712,120 lekë,	kualifikuar
7. "Junik" SHPK	99,999,999 lekë,	kualifikuar
8. "Rej" SHPK	101,060,925 lekë,	kualifikuar
9. "Zeqillari" SHPK	106,685,090 lekë,	kualifikuar
10. "Ndregjoni" SHPK	107,808,580 lekë,	skualifikuar

III.1.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "R&T" SHPK & "I.B.S" SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

-Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk plotëson të gjitha kërkesat e vecanat për kualifikim sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, Shtojca e 8 e DST, mbi disponimin e një punonjësi të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Për plotësimin e kësaj kërkesë vetëm antari i BOE operatori ekonomik "R & T" sh.p.k. ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon këtë punonjës, me iniciale E. N., si dhe ka paraqitur Çertifikatën e Kualifikimit me kod kursi HS003, lëshuar nga shoqëria Re Born. sh.p.k. dhe kohëzgjatje 80 orë.

Referuar Çertifikatës së Kualifikimit paraqitur ne Sisitemin e Prokurimit Elektronik, kohëzgjatja e kursit nuk plotëson kushtin në dokumentat e tenderit sipas shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, që çertifikimi përkatës të jetë në përputhje me VKM-në nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", ku në nenin 10 parashikohet se "Kursi I formimit për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të jetë me kohëzgjatje jo më pak 120 orë:

Neni 10 VKM-në nr.312, date 05.05.2010

3. Përmbajtja dhe kohëzgjatja e kurseve për të cilat flitet në pikën 2 duhet të respektojnë të paktën kërkesat e pikës së mëposhtme 8.

8. Kurs formimi për sigurinë e punës në sektorin e ndërtimit:

a) Kohëzgjatja 120 orë.

b) Përmbajtja legjislativi në fuqi për sa i përket fushës së sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës; sëmundje profesionale; statistikat mbi shkeljet e rregullave në kantiere; analizimi i rrezeve; rregullat teknike dhe kriteret për organizimin e kantierëve dhe kryerjen e punëve në kushte sigurie (përdorimi i makinave, PMP-ve, skelave dhe ndërtimeve të përkohshme etj.); metodat për përpunimin e planeve të sigurisë dhe të koordinimi."

III.1.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokolli 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ku nga shqyrtimi paraprak i saj, u konstatua se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kundërshton skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2022/2 prot., datë 23.07.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 438/8 prot., datë 29.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 2022/3 prot., datë 31.07.2024 me objekt “Dërgim vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet se ankesa është refuzuar.

III.1.7. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 05.08.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

III.1.8. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.9. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.10. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.11. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në

marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”

III.1.12. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, u konstatua se në datën 05.08.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit. KPP vëren, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK ka dorëzuar ankimin elektronik në sistemin elektronik të ankesave në datën 22.07.2024, ku kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar ende njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, në momentin e dorëzimit të ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik në momentin e paraqitjes së ankesës në datë 22.07.2024, nuk kishte filluar

akoma për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak i procedurës së prokurimit, i cili është publikuar në datë 05.08.2024.

Për sa më sipër, ankimi elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokoli 2022/2024, datë 22.07.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, do të konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me ankimin elektronik me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokoli 2229/2024, datë 07.08.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ku nga shqyrtimi paraprak i saj, u konstatua se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kundërshton skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, KPP vëren se,

III.2.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 438/13 prot., datë 15.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2229/3 prot., datë 16.08.2024 me objekt “Dërgim vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është pranuar plotësisht..

II.2.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK dhe me vendimin nr. 438/12 prot., datë 15.08.2024, ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...] Vendosi:

11. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “R&T” SHPK.

III.2.3. Neni 30 i LPP-së, e ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të*

ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik..

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; 70 ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankese nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji; b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.2.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në autoritetin kontraktor (referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar në KPP) dhe as në Komisionin e Prokurimit Publik, si dhe verifikimit në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konkretisht aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, kështu që rrjedhimisht, për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuar, Komisioni në mbështetje të nenit 115 pika 3 gërma a), mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankimin elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokollit 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mbyllë çështjen për ankimin elektronik me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokollit 2229/2024, datë 07.08.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 438/12 prot., datë 15.08.2024.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ankimin elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokollit 2022/2024, datë 22.07.2024.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për ankimin elektronik me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokollit 2229/2024, datë 07.08.2024.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

